



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Mbledhja nr. **70/2024**

Data: **23 Dhjetor, 2024. Ora: 13:30**

Vendi: **Selia e KQZ**

**Kryesues i KQZ-së:** Kreshnik Radoniqi.

**Anëtarët e KQZ-së:** Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,  
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Fazli Stollaj, Qemailj

Në takim ishin të Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

**U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP:** Besnik Buzhala

**Përkthyes:** Jehona Cami

**Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

---

**RENDI I DITËS**

---

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

---

**2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 69/2024**

---

**3. Aktivitetet e Zyrës:**

- 3.1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit të Zyrës për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës që mbahen me datën 9 shkurt 2025 (pjesa e dytë)
-

---

#### 4. Raport i Këshillave të KQZ

---

##### 4.1. Këshilli për Çështje Ligjore

4.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Podujevë

---

##### 4.2. Këshilli për Operacione Zgjedhore

4.2.1. Shqyrtimi vlerësimit të aktiviteteve të planit kohorë të aktiviteteve për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, 09.02.2024;

4.2.2. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit/ ndryshimeve të dokumentit “Specifikat për ngjyrën matriculuese”;

4.2.3. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit/ ndryshimeve të dokumentit “Specifikat për transportin e materialit sensitive dhe, jo sensitive”.

4.2.4. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimit i lokacioneve të QKN-ve, komunat Fushë Kosovë dhe Obiliq

---

#### 5. Të ndryshme !

---

##### 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

**Kreshnik Radoniqi**: Kryetari Radoniqi paraqiti rendin e ditës, dhe pastaj, ai e propozoi edhe një pikë: autorizimin e drejtorit të SKQZ për lidhje të marrëveshjeve me palë të treta. Pastaj, ai pyeti lidhur me rendin e ditës. Anëtarët, nuk kishin vërejtje, propozime etj. Me 11 vota për, u miratua rendi i ditës. Si në vijim, me 11 vota për u miratua edhe procesverbali nr. 69/2024 i KQZ.

##### 2. Aktivitetet e Zyrës:

Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit të Zyrës për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës që mbahen me datën 9 shkurt 2025 (pjesa e dytë):

**Besnik Buzhala**, drejtor i Zyres, tha se janë plotësuar kushtet që të certifikohet grupi i dytë i kandidatëve për deputet në zgjedhjet që mbahen më 9 shkurt, 2025, meqë ata, secili, kanë plotësuar

kushtet ligjore për aplikim, dokumentacionin, janë bërë verifikimit etj. Ky grup përmban gjithsej 17 subjekte politike, me 674 kandidatë. Grupi i dytë (II), ka 1 subjekt politik i përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës; 9 subjekte politike të regjistruara; 4 koalicione; 2 iniciativa qytetare dhe një (1) kandidat i pavarur. Subjektet politik që përfshihen në grupin e dytë të certifikimit, janë si në vijim:

1. **Koalicioni “AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma - Nisma Socialdemokrate, Lista Konservatore, Forumi intelektual, Forumi E- 30”**, me gjithsej: 110 kandidatë të përbashkët.

Kryesuesi z. Radoniqi, pyeti nëse ka dikush diçka...! Diskutuan, kryesisht mbi çështje shpjeguese, teknike, procedurale konform reformës zgjedhore, pastaj lidhur me dizajnin, specifikat e fletëvotimit: Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj.

**Kreshnik Radoniqi:** Me 11 vota për, certifikohet koalicioni: AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma - Nisma Socialdemokrate, Lista Konservatore, Forumi intelektual, Forumi E- 30, me 110 kandidatë.

2. **SRPSKA LISTA:** Z. Buzhala, në vazhdim tha se edhe ky subjekt i ka plotësuar kushtet për aplikim, dhe zyra rekomandon të certifikohet.

Kryesuesi z. Radoniqi, pyeti nëse ka dikush diçka lidhur me këtë rekomandim!

Diskutoi anëtari **Sami Kurteshi** i cili, fillimisht tha se, në relacion me këtë subjekt ka rezervat e tij që duhet ti shpreh! Vetë prezantimi i subjektit politik dhe prezantimi i kandidateve që u bë nga prezantuesi i listës, janë fakte të shumta. Ai, nuk e përmend emërtimin zyrtar asnjëherë por, thotë “Kosova i Metohija”, përmend njerëz që janë “utamniceni” që, domethënë janë nëpër skuta të errëta. Cilët janë ata njerëz ? Dhe e treta, në fund thotë “Rroftë shteti i Serbisë” si me u mbajtë zgjedhjet në Serbi. Tjetra, përfaqësuesit e kësaj liste mbajnë kontakte sistematike me Vuçiqin, po ku është edhe Radojqi, personi që ka qenë nënkryetar, ka organizuar dhe ka udhëheqë sulmin terrorist në Banjë ku është vra një policë. Ky subjekt kurrë nuk është deklarue me e dënua sulmin. Kemi lidhjen tjetër të sulmit në kanalin e Iber Lepencit. Këto janë elemente të shumta, pamje, fotografi, për shembull kryetari që ka qenë më parë, Rakiqi ka udhëheqë turma kundër KFOR-t, Policisë së Kosovës ku janë lënduar qindra vetë. Po kurrë nuk janë distancue. Unë, kam dëgjuar se ka presione, shantazhe ndaj anëtarëve të partive tjera nga Lista Serbe. Sipas mendimit tim, ky subjekt është strofull terrorist, e i cili edhe e ka pranue. Të gjitha këto janë elemente, prandaj çdo subjekt e ka për detyrë me i pranue do norma që të mos përdorë mjete të dhunës.

Në vazhdim, z. Kurteshi, e lëshoi në mbledhje – në prezencë të anëtarëve të KQZ-së, fjalimin e kryetarit aktual të Listës Serbe.

Ai, tha pastaj se, nuk do ta votojë një subjekt që nuk e pranon Republikën e Kosovës. Por, secili le të vendosë sipas ndërgjegjes së vetë, por ky subjekt nuk e meriton certifikimin dhe unë jam kundër...

**Alban Krasniqi:** Edhe unë ndaj mendimin e njëjtë, s'kam çka shtoj, vetëm them se janë dy organizata që janë shpallë si terroriste nga institucionet tona dhe ato kanë qenë pjesë e këtij subjekti që ka udhëheqë në katër komunat veriore. I kanë udhëheqë, kanë dhënë direktiva, kanë shantazhu për ta sfiduar vendin, qytetarët serb që jeton atje. Bazuar në këto arsye mendoj që ndërgjegjja jonë do duhej të dilte në krye të detyrës, sepse kushdo që e sfidon Kosovën ky subjekt nuk e njeh. Na rikthen në histori. As Milosheviqi nuk ju ka referue si "Kosova dhe Metohija" e këta, për mue janë alarm, po edhe për bashkësinë ndërkombëtare. Ajo që ka ndodh nuk është e falshme, ani se gjeneratat ndërrohen. Ndikimi rusi përmes Viiqit është duke i sfiduar shtetet e ndryshme ballkanike, edhe Kosovën e sfidojn përmes luftës hibride. Unë si anëtarë, nuk mund ta votojë këtë subjekt. Lista Serbe, garën e sheh si në një shtet tjetër. Ky subjekt, strukturat e këtij subjekti nuk e njohin shtetin e Kosovës...

**Arianit Elshani:** Realisht, qysh nga fillimi, ne e kemi ditur që kemi me ardhë deri te kjo situatë, që ka me ardhë edhe Lista Serbe. Ndaj të njëjtat shqetësime, si përfaqësues i Partisë Demokratike. Por, kemi një rekomandim nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike. Dhe ky subjekt, Lista Serbe i plotëson të gjitha kriteret ligjore për tu certifikuar. Rekomandimi i zyrës madje, vjen i bazuar edhe në qëndrimet Ministrisë së Brendshme, në Ministrinë e Jashtme dhe në PZAP, si dhe në Këshillin Gjyqësorë të Kosovës. Pra, të gjitha kanë dhënë qëndrime se mund të certifikohet. Unë, nuk do të marrë pjesë në votim, e tash nuk kemi konsensus ashtu si edhe në të kaluarën, e për çdo subjekt. Nëse dikush, apo ndonjë institucion vjen me tjetër qëndrim, pra le të sqarohet çdo gjë. Sepse, unë ndaj po këto shqetësime por e kemi rekomandimin e zyrës. Meqë ndaj shqetësim, nuk do të marrë pjesë në votim...

**Ilir Gashi:** Nuk është mirë që diçka e këtillë të bëhet mollë shërri këtu mes nesh, mes anëtarëve! Ajo që dihet, ligjërisht, ky subjekt në bazë të rekomandimit të zyrës ankohet diku tjetër, dhe e fiton të drejtën. Shqetësimet i kemi të njëjta, dhe nuk kemi nevojë të bëjmë politikë a patriotizëm ! E dimë cka ka ndodh, por më befason fakti se asnjë institucion i Kosovës qysh kur kanë ndodh ngjarjet askush nuk ka marrë ndonjë hap që ta privojë këtë subjekt me ndonjë vendim si kriminal. Ne, nuk e kemi këtë të drejtë. Nuk ka marrë askush veprim, as nga qeveria, as nga gjyqësia, dhe nga askush tjetër. Po të kishim një vendim, ne do ta kishim shumë më lehtë sot. Nuk dyshoj që zyra nuk e ka kryer punën me përgjegjësi, por as unë nuk do të marrë pjesë në votim. Por, nuk është mirë që me veprimin tonë, ne ti kontribuojmë këtij subjekti ti "dërgojmë vota", dhe rezervohem për ta votuar.

**Sami Kurteshi**: E dëgjova kolegun, e gjuan topin andej – këndeje por unë i nxora faktet që si ka pas përpara as zyra. Tash, kam edhe një incizim tjetër që subjekt tjetër serb, e akuzon drejtpërdrejt listën serbe për shatazh.

Në vazhdim. Z. Kurteshi e lexoi një paragraf të ligjit zgjedhor, nenin 35 që fletë për përdorim dhune, kërcënon dhe se, ky nen ndalon. Por, ne e kemi edhe kodin e sjelljes. Janë norma që i ka miratuar Kuvendi, dhe i kemi miratuar edhe ne...Lista serbe, është bërë strofull e terrorizmit...

Unë, thjeshtë, nuk jam në gjendje ta ngris dorën për certifikimin e këtij subjekti politik...

**Alban Krasniqi**: Këto që tham ne, edhe mund të shërbejnë për institucionet tjera, shërbejnë edhe për prokurorinë që të ndër marrë masa...! Por, ne e dimë historinë e Listës Serbe e cila, me dhunë e shantazh i ka fituar zgjedhjet, qysh i ka marrë votat, mandatet...

Nuk është marre me pranue se kontrolli i KQZ, qoftë në zgjedhjet lokale dhe qoftë në ato për kuvend, ka qenë zero! Ne, e dimë mbushjen e kutive në 2010...

**Qemal Kurtis**: Unë kisha propozuar që ta shtyjme në një ditë apo dy, ti konsultojme organet tjera që të mos na mbetet “patatja e njetë” në duar. Teknikisht duket në rregull, por këto që i dëgjuam edhe unë pajtohem me diskutimet... Mos të futemi në ujërat politike, por të analizojmë mirë dhe të shohim se, a ta certifikojmë a jo, ta prolongojmë, por të mos biem në ndonjë gabim...

**Arianit Elshani**: E dimë kush është lista serbe, dhe kush janë akterët brenda listës! Por, mirë është me na tregue me letra, me dokumente institucionet tona. Dhe, të na thonë saktë ato se kush është, cka, me dokumente, me rekomandime ligjore...Kryetar, po e përsëris, diskutoni edhe me institucionet tjera dhe ejani me qëndrim të qartë, me rekomandim: për, apo kundër...

**Kreshnik Radoniqi**: Mendoni ta shtyjme, apo ta qesim në votim. Nuk jam për me shty...

Në vazhdim, diskutoi sërish Alban Krasniqi, dhe tha se lista serbe nuk duhet të certifikohet, se çdo gjë është e qartë rreth saj.

**Kreshnik Radoniqi**: A ka dikush tjetër...? Nuk kishte diskutime tjera. Prandaj, me 2 vota për, 2 kundër dhe të tjerët anëtarë abstenuan të marrin pjesë në votim, Lista Serbe nuk u certifikua. Rekomandimi i zyrës, nuk kaloi...

3. FJALA, me 22 kandidatë, me 11 vota për certifikohet.

4. PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS, me 56 kandidatë, me 11 vota për certifikohet.

5. PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE-PLE, me 61 kandidatë, me 11 vota për certifikohet.
6. SRPSKA DEMOKRATIJA, me 13 kandidatë, me 11 vota për certifikohet.
7. Yenilikçi Türk Hareket Partisi, me 25 kandidatë, me 11 vota për certifikohet.
8. Kosova Adalet Türk Partisi, me 1 kandidatë, me 10 vota për certifikohet.
9. Koalicioni për Familje, me 71 kandidatë, me 10 vota për certifikohet.
10. Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar, me 95 kandidatë, me 10 vota për certifikohet.
11. Srpski narodni pokret, me 12 kandidatë, me 10 vota për certifikohet.
12. Partija Kosovskih Srba, me 9 kandidatë, me 10 vota për certifikohet.
13. Koalicioni PDAK-LPB, me 100 kandidatë, me 10 vota për certifikohet.
14. Koalicioni “Naša Bošnjačka Koalicija” (Naša Inicijativa i Bošnjačka stranka), me 28 kandidatë, me 10 vota për certifikohet.
15. Inicijativa qytetare “GRADJANSKA INICIJATIVA NARODNA PRAVDA”, me 10 kandidatë, me 10 vota për certifikohet.
16. Opre Roma Kosova, me 12 kandidatë, me 10 vota për certifikohet.
17. Kandidati i pavarur “FATMIR BYTYQI”, me 10 vota për certifikohet.

**Qemailj Kurtis**, tha për Sekretariatit se ka vërejtje nga diaspora se atyre ju drejtohen vetëm në gjuhën shqipe, por jo edhe në gjuhën e tyre amtare. Ata, nuk dinë shqip. Ka raste, që edhe në telefon lajmërohen por ka problem me komunikim. Mos të shkaktohet diskrimin...!

**Kreshnik Radoniqi**: Unë nuk di që dikush ka pos problem, që është refuzuar por e kemi futur edhe në agjendë që me e zgjidhë këtë problem...

Diskutoi edhe Sami Kurteshi, i cili tha se nuk di të ketë raste, Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Kreshnik Radoniqi.

### **3. Raport i Këshillave të KQZ**

#### **1. Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Podujevë:

**Sami Hamiti**, tha se në takimin e 13-të të këshillit, është shqyrtuar kërkesa për zëvendësimin e dy anëtarëve të kuvendit komunal në Podujevë. Janë plotësue kushtet. Në kontekst, Qëndresa Haliti rekomandojmë që të zgjidhet anëtare e kuvendit komunal, e cila e zëvendëson anëtarin e deritashme, Arijeta Salihu-Abazi nga subjekti politik LDK.

Me 10 vota për, miratohet ky rekomandim.

Po ashtu, Fatmir Gashi rekomandojmë që të zgjidhet anëtar i kuvendit komunal, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm Qëndrim Softollin nga subjekti politik LDK.

Me 10 vota për, miratohet ky rekomandim.

## **2. Këshilli për Operacione Zgjedhore**

### 1. Shqyrtimi i vlerësimit të aktiviteteve të planit kohorë të aktiviteteve për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, 09.02.2024:

**Arianit Elshani**, tha se KOZ ka shqyrtuar dhe vlerësuar planin kohorë të aktiviteteve zgjedhore. Ne, kemi ndarë kërkesën e z. Selmanaj që ishte për shqyrtimin e kalendarit të aktiviteteve dhe që hedhjen e shortit që është e planifikuar më 7 janar, të bëhet më 29 dhjetor. Mirëpo, kjo do të shqyrtohet nesër, dhe duket se do të varet nga çështjet që po dalin në vijim... Po ashtu, ka qenë edhe kërkesa e nominimit të komisionerëve të partive politike që të zhvendoset më datën më 30 dhjetor, janë diskutuar edhe afatet e tjera si ajo e votimit jashtë Kosovës që përfundon më 26 dhjetor. Por ka interferime, dhe Sekretariati duhet të hartojë një raport sepse, ka çështje të ndryshme që duhet shqyrtuar... Kemi diskutue të zgjatet afati, mirëpo për shkak të shumë veprimeve që duhet të ndiqen, nëse mund të përballohet gjendja sepse ka shumë aplikime, pra duhet një plan veprimi nuk mund ta bëjmë... Ta shqyrtojmë këtu...

**Alban Krasniqi**, tha se kemi kërkuar që sot të kemi përgjigje. Sot është data 23, dhe nuk mund të presim por mendoj që janë të gjitha parakushtet të zgjatet afati. Kemi pasur madje, edhe ndërprerje të rrymës, bartje të sistemit që ka ndikue në ndërprerjen e shërbimit. Ky është një aspekt teknik që kërkon nevojë të shtyhet. Së paku deri më 29 dhjetor, shtyrja nuk interferon në asnjë afat... Shembull, ishte edhe ajo që tha Qemajli ! Janë edhe disa probleme të informimit që, kanë dështuar si informimi përmes IPKO –s etj. Kërkesat për regjistrim, janë rritur...

Shërbimit votues, ne i kemi ofruar shumë përkrahje ! Ti kemi parasysh mundësitë, po edhe problemet që mund ti kemi në ditën e votimit, prandaj qysh tash duhet tu paraprijmë çështjeve cilat do qofshin, tha z. Krasniqi në mënyrë që, secilit qytetar me të drejtë vote t'ia ofrojmë mundësinë e votimit...

**Ibrahim Selmanaj**: Po e kemi shqyrtuar, dhe kemi edhe 3 ditë deri në mbyllje të afatit për votuesit jashtë vendit. Shërbimi votues, mund të na sjellë një raport, duke analizuar edhe afatet e mundeshe rrjedhëse. Nuk ka ndoj sfidim, vetëm ti shohim mundësitë...

**Arianit Elshani**: Edhe po të shtyhet deri më 15 janar, kjo nuk më shqetëson. Por, ky afat, ishte qysh nga gushti, tejet mjaftueshëm. Por, shoh probleme teknike, madje ka shumë çështje procedurale, aso që duhet të shqyrtohen... Nëse ka mundësi Sekretariati, pse jo por duhet ta kemi rekomandimin e sekretariatit.

**Kreshnik Radoniqi**: A e lëmë të vendosim nesër, apo kur...?

Diskutuan: Sami Kurteshi, i cili tha se atij i është lajmëruar ambasadori në Japoni. Nuk janë më shumë se 100 votues. Ambasada, ka kushte të mira atje për tu mundësuar votimi edhe në Japoni...

**Sami Hamiti**: Kemi diskutuar, mirëpo ka edhe hezitime në Sekretariat. Mund ta rrezikojmë certifikimin e listës votuese. Ti shohim afatet. Le të shkoj proceset si duhet...

**Besnik Buzhala**: E shohim me departamentin e shërbimit votues, dhe vlerësojmë...

2. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit/ndryshimeve të dokumentit “Specifikat për ngjyrën matrikuluese”:

**Arianit Elshani**: E kemi shqyrtuar edhe këtë pikë, këto specifika. Tenderi ka dështuar dy herë. Tash, ne rekomandojmë për miratim, meqë kemi ardhë në përfundim që të vazhdojmë...

Me 10 vota për, miratohet.

**Shqyrtimi dhe miratimi i plotësimit/ ndryshimeve të dokumentit “Specifikat për transportin e materialit sensitive dhe, jo sensitive”:**

**Arianit Elshani**, shpjegoi se janë plotësua kushtet që edhe kjo pikë të miratohet. Është analizuar me vëmendje, dhe kemi kërkuar që siguria të jetë e duhur, dhe në mënyrë profesionale...

Me 10 vota për, miratohet.

**Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimit i lokacioneve të QKN-ve, komunit Fushë Kosovë dhe Obiliq:**

**Arianit Elshani** tha se, është shqyrtuar dhe analizuar ndryshimi i lokacioneve të QNK-ve në këto dy komuna. Kemi shqyrtua mundësitë, çështjet teknike, të hapësirës etj. Kështu, QNK “Daut Bogujevci” në Fushë Kosovë plotëson kushtet. Dhe, në Obiliq salla e shkollës të shërbej si QNK sepse, është më e



përshtatshme. Kemi kërkuar që po të jetë nevoja, kudo, të bëjmë ndryshime në mënyrë që të mos kemi kësi probleme.

**Alban Krasniqi**: Mendoj që DOZ duhet të bëj një raport për të gjitha QNK-të në mënyrë që, të mos kemi asnjë problem, çka do qoftë. Komuna duhet siguroj përgjegjësitë që të komunikojnë KKZ-të. Po ashtu, QNR nuk më duket ende në nivel, sepse ende nuk është akomodu. Të lirohet QNR, hapësira e saj...

Me 10 vota për, miratohet ndryshimi i lokacioneve të QKN-ve, në komunat Fushë Kosovë dhe Obiliq

**Kreshnik Radoniqi**: E kemi edhe një pikë: miratimi i autorizimit për Drejtorin që të lidhë marrëveshje me palët e treta. Është fjala për angazhim të përkthyesit.

Me 10 vota për, miratohet.

#### **4. Të ndryshme !**